

Shërbimet Gjuhësore & Edukimi Special Qyteti i Nju Jorkut

Nëse jeni prindi ose personi përgjegjës i fëmijës që merr apo është në nevojë të shërbimeve të edukimit special, keni të drejtë që të ndihmoni për të krijuar dhe për të zgjedhur programin e edukimit special të fëmijës suaj. Nëse gjuha juaj amtare nuk është anglishtja, keni të drejtën e shërbimeve të përkthimit (dokumente me shkrim të përkthyer në gjuhën tuaj) dhe shërbimeve të interpretimit (përkthimi me gojë në gjuhën tuaj), me qëllim që ju të mund të kuptoni dhe të ndihmoni për të krijuar programin e edukimit special të fëmijës suaj.

Shkollat dhe Komisionet mbi Edukimin Special (CSE-së) janë të përgjegjshme për përkthimin e dokumenteve dhe për të siguruar që përkthyesit janë të pranishëm në mbledhjet midis prindërve dhe anëtarëve të Ministrisë së Arsimit të qytetit të Nju Jorkut (DOE). DOE-së i kërkohet që t’ju pajisë me këto shërbime edhe nuk mund t’ju kërkojë apo t’ju shtyjë të sillni dikë që të përkthejë për ju në këto mbledhje. Megjithatë, ju prapë mund të zgjidhni që të sillni një mik të moshës madhore apo të afërm për të përkthyer në këto mbledhje. DOE-së nuk i lejohej në asnjë mënyrë të përdorë një fëmijë si përkthyes.

PËRKTHIMI ME SHKRIM

Keni të drejtë të merrni informacionin e mëposhtëm në gjuhën tuaj amtare:

- **Njoftimi i lejes për vlerësim:** Kjo është një letër që shkolla duhet t’ju dërgojë kur i nevojitet leja juaj për të vlerësuar ose për të marrë në provim fëmijën tuaj, me qëllim që të kuptojë nëse ai /ajo ka nevojë për shërbime të edukimit special.
- **Njoftim i mbledhjes:** Kjo letër ju vë në dijeni kur organizohet një mbledhje.
- **Raporte vlerësimi:** Këto raporte dalin nga rezultatet e provimeve të kryer nga DOE-ja, që tregojnë nëse fëmija juaj ka aftësi të kufizuara në lidhje me mësimin, si dhe tregon se çfarë shërbimesh i nevojiten atij /asaj.
- **Njoftimi përfundimtar i rekomandimit:** Kjo letër ju lejon të dini ndryshimet që DOE-ja planifikon të bëjë tek shërbimet e edukimit special të fëmijës suaj.
- **Programi i Individualizuar i Edukimit (IEP):** Ky dokument përshkruan se çfarë programesh dhe shërbimesh të edukimit special duhet të marrë fëmija juaj.
- **Dëftesat /Raportet e përparimit:** Këto dokumente shpjegojnë se çfarë rezultatesh ka fëmija juaj në shkollë.
- **Njoftimi i mbrojtjes së procedurave:** Ky dokument shpjegon të drejtat tuaja si prind i një fëmije që po merr shërbime të edukimit special.
- **Marrëveshje ndërmjetësimi:** Kjo është një marrëveshje ligjore që bëhet pas mbledhjes (një “seancë ndërmjetësimi”) ndërmjet jush dhe DOE-së, që shpjegon se si e keni zgjidhur një mosmarrëveshje në lidhje me programin e edukimit special të fëmijës suaj.
- **Marrëveshja e zgjidhjes së çështjes:** Kjo është një marrëveshje ligjore që bëhet gjatë një mbledhjeje (një “seancë zgjidhjeje të shqetësimit”) ndërmjet jush dhe DOE-së, që mund të

ndodhë para një seance dëgjimore të paanshme. Kjo marrëveshje shpjegon se si e keni zgjidhur një mosmarrëveshje në lidhje me programin e edukimit special të fëmijës suaj.

- **Vendimi i seancës dëgjimore të paanshme:** Kur ju dhe DOE-ja nuk mund të merreni vesh në lidhje me programin e edukimit special të fëmijës suaj (dhe gjithashtu nuk bini dakord në seancat e ndërmjetësimit dhe të zgjidhjes), ju mund ta paraqisni çështjen tuaj në një seancë dëgjimi të paanshme tek oficeri përkatës i kësaj seance dëgjimi, që merr vendimin në lidhje me programet dhe shërbimet që fëmija juaj ka të drejtë të marrë nga DOE-ja. Ky është një vendim me shkrim që jepet nga drejtuesi i seancës dëgjimore pas seancës dëgjimore të paanshme.

PËRKTHIMI ME GOJË

Ju keni të drejtën e një përkthyesi që flet rrjedhshëm në gjuhën tuaj amtare në situatat e mëposhtme:

- **Mbledhja e IEP-së:** Mbledhje për të krijuar, diskutuar, apo shikuar programin e edukimit special të fëmijës suaj, i cili quhet Programi i Individualizuar i Edukimit (IEP).
- **Përsëritja e CSE-së:** Mbledhje që shikon IEP-në e fëmijës suaj me CSE-në. CSE-ja është pjesë e DOE-së dhe ka përgjegjësi mbi edukimin special.
- **Seanca e ndërmjetësimit:** Mbledhje ndërmjet jush, CSE-së apo shkollës dhe dikujt tjetër që është i paanshëm e që ndihmon të zgjidhë mosmarrëveshjet në lidhje me programin e edukimit special të fëmijës suaj.
- **Seanca e zgjidhjes së çështjes:** Mbledhje ndërmjet jush dhe CSE-së që ndodh para një seance dëgjimore, në të cilën bini dakord në lidhje me programin e edukimit special të fëmijës suaj.
- **Seanca dëgjimore e paanshme:** Seancë dëgjimore që ndodh kur ju dhe CSE-ja nuk bini dakord në lidhje me programin e edukimit special të fëmijës suaj, si dhe ku çështja i paraqitet një zyrtari të paanshëm të seancës dëgjimore, person që vepron si gjykatës dhe që merr vendimin përfundimtar në lidhje me programet dhe shërbimet që fëmija juaj ka të drejtë të marrë.

TË DREJTA TË TJERA

Ju keni të drejtën të merrni dokumente të përkthyer që u dërgohen të gjithë prindërve brenda qytetit. Këto mund të përfshijnë informata në lidhje me regjistrimin në shkollë të fëmijës suaj, aplikimin dhe zgjedhjen e shkollës, si dhe matjen e suksesit të fëmijës në shkollë. Për më tepër, gjithashtu duhet të merrni informacion të përkthyer në lidhje me sjelljen, sigurinë dhe disiplinën e fëmijës suaj. Gjithashtu keni të drejtën e një përkthyesi në të gjitha mbledhjet në shkollë qyteti, mbledhjet e Panelit të Rregullores së Edukimit; mbledhjet e Prindërve që Mësojnë Gjuhën Angleze në shkollë qyteti; mbledhjet e Këshillit të Edukimit të Komunitetit në shkollë qyteti; si dhe mbledhje të tjera të prindërve në shkollë qyteti të organizuara nga zyrat qendrore. Gjithashtu duhet t'ju sigurohen shërbime përkthime në mbledhjet e Shoqatës Prindër - Mësues (PTA) të mbajtura në shkollën e fëmijës suaj.

MERRNI MASA!

Nëse shkolla ku mëson fëmija juaj nuk ju ka siguruar shërbime përkthimi, mund të dërgoni një letër tek shkolla për t'i kërkuar ato shërbime. Nëse keni pyetje rreth kësaj letrë apo dokumenti faktesh, atëherë lutemi kontaktoni New York Lawyers for the Public Interest në numrin (212) 244-4664 apo Advocates for Children of New York në numrin (212) 822-9521.

Nëse shkolla apo zyra e DOE-së nuk jua përkthen dokumentet që kërkon, mund të ankoheni duke marrë në telefon Zyrën për Angazhimin dhe Mbrojtjen e Familjes (OFEA) në numrin (212) 374-2323, ose duke i dërguar zyrës një kopje të letrës suaj me anë të faksit në numrin (212) 374-0138.